

ADMINISTRATA PUBLIKE DERI NË VITIN 2020


PËR NJË ADMINISTRATË QË SHPENZON ARSYESHËM

Reforma e Menaxhimit të Financave Publike deri në vitin 2020, duhet të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë dhe të sigurojë një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët.

Objektivat kryesore të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike janë:


KUADRI FISKAL I QËNDRUESHËM, PLANIFIKIMI DHE BUXHETIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE

Planifikimi i buxhetit shpesh nuk është në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë, madje nuk matet as ndikimi që ka në efikasitetin e ekzekutimit të buxhetit. Për zbatimin e buxhetit kapital është i nevojshëm një planifikim dhe raportim më i mirë, që përfshinë investim afatgjatë në zhvillimin e infrastrukturës.



EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Mbledhja më e mirë e taksave duhet të ndikojë në rritjen e të ardhurave të buxhetit shtetëror. Mënyra sipas të cilës autoritetet publike bëjnë prokurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe kontraktajn kryerjen e punëve, duhet të përmirësohet sikur edhe menaxhimi i borxhit publik.



ZHVILLIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR

Përveç aktorëve të jashtëm të cilët vlerësojnë funksionimin e organeve të administratës publike, siç është Institucion Shtetëror i Auditimit, administrata publike duhet të punojë për zhvillimin e burimeve të brendshme për mbikëqyrjen e menaxhimit të financave publike në radhët e veta.



LLOGARIDHËNIE MË E MIRË: KONTABILITET DHE RAPORTIM FINANCIAR TRANSPARENT

Mënyra sipas të cilës administrata jonë menaxhon llogaritë nuk është në përputhje me standardet e një praktike të mirë. E thënë ndryshe, të dhënat për financat tona publike nuk janë në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare, i cili paraqet një kornizë të nevojshme statistikore për monitorimin e zhvillimeve ekonomike në secilin vend.



PËRMIRËSIMI I PUNËS SË INSTITUCIONIT SHTETËROR TË AUDITIMIT

Është i nevojshëm menaxhimi më i mirë i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i aftësive profesionale të auditorëve. Gjithashtu është i nevojshëm bashkëpunimi më i mirë ndërmjet Institucionit Shtetëror të Auditimit dhe Kuvendit, veçanërisht në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit.

TRANSPARENCA BUXHETORE

Informacionet për shpenzimet buxhetore ende nuk janë të plota dhe të sakta. Të dhënat në raportet e ekzekutimit të buxhetit janë shpesh të përbledhura dhe është shumë e pamundur të dihet në detaje se SA paraqet dhe për ÇFARË?

